



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**DREJTORIA E PERGJITHSHME E MIREMBAJTJES SE OBJEKTEVE PUBLIKE**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025

**PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHERBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

I mbajtur sot me datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2025 , në ambientet e Drejtorise se Pergjithshme te Mirembajtjes se Objekteve Publike , mbi llogaritjen e fondit limit dhe rgumentimin dhe miratimin e kriterëve kualifikuese për procedurën e prokurimit me objekt: "**Projektim Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi** ", nga ing.Viktor Sheldija si personi përgjegjës në zbatim të Urdhërit të Titullarit të Autoritetit Kontraktor Nr. \_\_\_\_ dt \_\_\_\_/\_\_\_\_/ 2025 si dhe bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**Kodi CPV:** 22114311-5 - Projekte,

Ky procesverbal mbahet në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe të nenit 41, “**Kërkesa të veçanta për kontratat e sherbimeve**”.

Njësia e Prokurimit, personi përgjegjës dhe specialist të fushës, bazuar nenin 74 pika 3 “Personi përgjegjës për prokurimin dhe pika 4, “Specialistet e fushës” në njësinë e prokurimit” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në njohuritë e secilit anëtar, hartoi dokumentacionin e plotë për zhvillimin e procedurës së prokurimit, duke bërë kujdes të veçantë në miratimin e kërkesave të veçanta kualifikuese me qëllim zbatimin sa më drejt të rregullave të Prokurimit Publik.

Detyrat e anetareve të Njesise janë të ndara dhe të percaktuara qartë në baze të njohurive dhe kualifikimeve të secilit prej anetareve të Njesise së prokurimit dhe me konkretisht kriteret për kualifikim në lidhje me piken Kapaciteti ekonomik dhe financiar, hartohen dhe janë përgjegjësi e zj Aurora Shkjau , me profesion ekonomist në cilësinë e personit përgjegjës për prokurimin, kriteret për kualifikim në lidhje me piken Aftësitë teknike dhe profesionale hartohen dhe janë përgjegjësi e z.Viktor Sheldija me profesion inxhinier ndertimi , në cilësinë e specialistit të

fushes po ashtu zj. Nikoleta Lami është anetar i Njesise se prokurimit ne cilesine e hartuesit te termave te references.

Bazuar nenin 74 pika 3, shkronja ç, “Personi pergjegjes per prokurimin”, zj. Aurora Shkja është personi pergjegjes per përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme, që u bashkëlidhen atyre.

Bazuar ne Udhezimin Plotesues nr.2 date 19.01.2023”Per zbatimin e Buxhetit te vitit 2023”pika 38, Udhezimin e Ministrise se Financave nr.24 date 29.08.2019”Per perdorimin e arkives elektronike ne procesin e ekzekutimit te Buxhetit te Shtetit nga Njesite e Qeverisjes se Pergjithshme“ i gjithë dokumentacioni i parashikuar ne piken 1, si Urdher Prokurimi, Urdher Kerkese Blerje dhe procesverbali i fondi limit u skanuan dhe pas miratimit ne sistemin AFMIS nga Nenpunesi Zbatues dhe Nenpunesi Autorizues iu derguan per miratim ne sistem SIFQ nenpunesit te ngarkuar i Deges se Thesarit Shkoder.

Gjithashtu bazuar ne Udhezimin e Perbashket te Ministrise se Financave dhe Agjencise se Prokurimit Publik date 29.12.2021 per Integrimi i Sistemit të Prokurimit Elektronik me AFMIS para fillimit të procedurës së prokurimit në SPE, njësia e prokurimit duhet të marr pranë strukturës së financës të të njejtit institucion numrin e transaksionit të kërkesë blerjes (urdhërit të prokurimit) të regjistruar dhe aprovuar paraprakisht në sistemin SIMF dhe SIFQ, Transaksioni i kërkesë blerjes i regjistruar në SIMF dhe SIFQ duhet të ketë statusin “Aprovuar”, në të kundërt nuk do të shfaqet në fushën respektive në sistemin SPE. Statusi “Aprovuar” nënkupton që në sistemin Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) ka fonde të vlefshme buxhetore për zhvillimin e procedurës respektive të prokurimit.

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë “ **Procedurë e hapur e thjeshtuar**“ mbështetur në nenin 49 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe sipas nenit 55 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“.Arsyeja e përdorimit të kësaj procedure prokurimi është pasi vlera e fondit limit është nën kufirin e ulet monetar, sipas percaktimeve të nenit 11, pika 1 të VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“.

Bazuar ne ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik neni 39 dhe VKM nr. 285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik“, neni 42, kontrata është ndare në lote, pasi përbëhet nga shërbime të ngjashme dhe vlera e kombinuar është e tillë që vetëm një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë do të ishin në gjendje t’i siguronin ato. Gjithashtu vendi i kryerjes së shërbimit është i shpërndarë dhe për një operator ekonomik do të ishte e pamundur realizimi i shërbimit.

Njesia e prokurimit u mblodh për hartimin e dokumentacionit të tenderit në mbështetje të Urdhërit të Prokurimit **Nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_.**

Përlllogaritja e fondit limit dhe miratimi i termave të referencës të nevojshme për procedurën e prokurimit janë hartuar nga z.Viktor Sheldija bazuar në VKM Nr. 285, datë 19.5.2021”Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 12”Metoda të zbatueshme në përlllogaritjen e vlerës së kontratës” neni 76”Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” si dhe Ligjit Nr. 162/2020”Për prokurimin publik” Neni 34”Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, Neni 36”Specifikimet teknike” dokumentuar me **procesverbalin për përlllogaritjen e fondit limit dhe termave të referencës Nr.\_\_\_\_, datë \_\_\_\_.**

Llogaritja e vlerave minimale dhe maksimale për secilin objekt janë bërë nga **z.Viktor Sheldija** me profesion inxhinier ndertimi, bazuar në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim” dhe Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) Nr. 5585 Prot, datë 25.07.2017,” Mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin nr.354, datë 11.05.2016, të Këshillit të Ministrave” me qëllim respektimin nga operatorët ekonomikë të normave minimale (vlerave minimale të lejuara), të specifikuara në këtë vendim

**Vlera e fondi limit është 4,999,556 (Katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë )pa TVSH " Projektim Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi "**

Vlera e fondit limit është brenda vlerës së regjistrit të parashikimeve të miratuar pranë Degës së Thesarit dhe të parashikuar në sistemin elektronik të APP.

Kjo procedurë prokurimi është parashikuar në Buxhetin e Bashkisë për vitin 2025 sipas VKB Nr. 41, datë 25.06.2025 "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 76 datë 19.12.2024 “për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të bashkisë shkodër

Njësia e Prokurimit hartoi dokumentet e tenderit në përputhje me dokumentat standarde të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik sipas Vendimin **nr.03, datë 09.06.2021** ”Për miratimin e dokumentave standarde të tenderit për mallra, punë, shërbime për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e Thjeshtuar ” i ndryshuar me Vendimin nr.8 datë 05.10.2022 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, neni 14,pika 2.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm Njësia e Prokurimeve nisi punën për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Njësia e Prokurimit në hartimin e dokumentave standarde të tenderit, hartimin e kërkesave për kualifikim bazohet në ligjin Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, neni 3“Parimet e përgjithshme”,neni 18“ Mbrojtja e integritetit të procedurës dhe masat e përgjithshme për parandalimin e korrupsionit”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”e ndryshuar, neni 25 ‘Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes’, neni 41 ”Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, neni 78 ”Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”.

### **Njësia e Prokurimit diskutoi pikat dhe kriteret e mëposhtme dhe me unanimitet vendosi:**

1. Hartimin e dokumenteve të tenderit, njoftimin e kontratës, kërkesave për kualifikim si dhe publikimin e Njoftimit të Kontratës në sistemin elektronik të APP për botim në Buletinin e Agjensisë së Prokurimit Publik.

2. Procedura e prokurimit me objekt: "**Projektim Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi** ", "**Procedurë e hapur e thjeshtuar**" mbështetur në ligjin me nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 49, neni 55 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me një vlerë kontrate nën kufirin e ulët monetar sipas nenit 11 i VKM nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Arsyeja e përdorimit të kësaj procedure prokurimi janë kufijtë monetarë.

3. Bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 74 dokumentacionin teknik dhe ligjor në sistemin elektronik të APP do hidhet nga personi përgjegjes për prokurimin zj. Aurora Shkaj

4. Njesia e Prokurimit plotësoi formularët e deklarimit të konfliktit të interesit, në mbështetje të parashikimeve ligjore të nenit 19 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, të nenit 73, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe në Udhezimin Nr.1, datë 21.01.2022”Mbi Deklarimin e Konfliktit të Interesit nga Zyrtaret/Nepunesit në procesin e prokurimit dhe zbatimin e kontrates”.

5. Nuk ka pagesë për blerjen e dokumentave.

6. Afati i realizimit të shërbimit do të jetë 45(dyzet e pesë dite) dite kalendarike në përmbushje të nevojave të këtyre drejtorie. Ky afat është vendosur duke u mbështetur tek natyra e shërbimit, vlera e kontrates, termave të referencës dhe nga eksperiencia e viteve të kaluara që ka rezultuar i mjaftueshëm për operatorët ekonomikë për realizimin me sukses të tyre

7. Bazuar në nenin 94 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 24, pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” u vendos që vlefshmëria e ofertës do të jetë 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë nga dita e dorëzimit të ofertave duke gjykuar si afat të mjaftueshëm si periudhë për zhvillimin e procedurës së prokurimit.

8. Bazuar në nenin 87 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 45 ” Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, u vendos që kriter vlerësimi do të jetë oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim. Kriter për përzgjedhjen e fituesit do të jetë oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”

9. U vendos që në respektim të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, neni 49 ku për kontratat me vlerë nën kufirin e ulët monetar afati i hapjes së ofertave do të jetë minimumi 10 ditë nga dita e shpalljes të procedurës së prokurimit në SPE.

10. Bazuar në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” neni 83, dhe VKM nr.285, dt. 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 30, u vendos që vlera e sigurimit të ofertës të jetë **99,991.12 (Nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e një pikë dymbëdhjetë) lekë pa tvsh**

Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

11. U vendos që Kriteret e Përgjithshme e të Veçanta të kualifikimit të jenë si më poshtë:

## **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës ...;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës...

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të Nenit 26 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”,

## **Projektim Rikonstruktion Shkolla Ndoc Mazi**

### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

#### **2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik sipas Shtojcës 8.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

#### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të konkretisht **1,999,822.4 (Një milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e njëzet e dy pikë katër)** lekë.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” “Ne lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetit ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë që operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedure është “Sherbim Konsulence”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: “40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit..... dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim Konsulence” si dhe në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ” Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare(2022,2023,2024). Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të VKM nr.285,date 19.05.2021, neni 43,pika 4(shëno bazën ligjore), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.



**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.*

**2.2.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ka ushtruar aktivitet për vitin 2024 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentet e kërkuar më sipër do të paraqitet përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2024, pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Shënim:** Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare (lista e shkurtër), duhet te dorezojnë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet te paraqitur në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

## **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

**2.3.1.** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës/lotitit, që prokurohet dhe konkretisht **999,911.2 (Nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë pikë dy) lekë.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** Për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e nënshkruar me entin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Enti Publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera dhe afati i përfundimit të kontratës.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77”Kerkesat per kualifikim”, te Ligjit Nr 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” pika 4..”*ne lidhje me aftesite teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund te vendosin kerkesa qe garantojne se operatoret ekonomike zoterojne burimet e nevojshme njerezore e teknike, si dhe pervojen e nevojshme per te zbatuar kontraten sipas nje standardi te pershtatshem cilesie. Autoritetet ose entet kontraktore, ne vecanti, mund te kerkojne qe operatoret ekonomike te kene nje nivel te mjaftueshem pervoje qe vertetohet nga referenca te pershtatshme nga kontrata e zbatuara ne te shkuaren*”dhe nenit 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Per kontrata e mallrave dhe sherbimeve vlera totale e kerkuar duhet te jete ne nje vlere jo me te madhe se 20 % te vleres se perlllogaritur te kontrates, qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate tre viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates”*”.

**Argumentimi** Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.



Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marre ne konsiderate vleren e fondit limit te sherbimit te kerkuar objekt procedure prokurimi, eshte menduar se vlera e kerkuar qe OE ofertues te kete realizuar kontrata te ngjashme, te jete afer limitit maksimal te lejuar dhe ne kete menyre, AK ka sigurine dhe besueshmerine qe OE ofertues mund te realizoje kontraten objekt prokurimi pa patur pengesa te ndryshme qe do te ndikonin ne ecurine e punes se AK.

### **2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:**

#### **PROJEKTUES ARKITEKT**

- a- Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.
- b-1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore; 3. objekte spitalore; terminallet në infrastrukturë; vepra arti në infrastrukturë.
- c- Projektim interiere.
- d- Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.

#### **PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- a- Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- b-1. Objekte civile - industriale - turistike mbi 5 kate - 2. objekte me skelet metalik.

#### **PROJEKTUES INSTALATOR**

- a- Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.
- b- Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.
- c- Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.
- f- Projektim të sistemeve kundra zjarrit.
- i- Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.
- j- Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale

*Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MIE ose*

institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim- përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Liçensat e mesiperme janë vendosur në kuader të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Për arsye të vështirësisë së objekteve të kontratës, rendesise strategjike të tyre, që lidhen jo vetëm me vendosjen e objekteve në zona zhvillimore me intesitet të lartë qarkullimi dhe zona studentore të rendesise strategjike për zhvillimin e sektoreve të arsimit të lartë, zona me infrastrukturë ekzistuese mbi dhe nëntokësore, si dhe kërkesave për cilësi sipas standarteve bashkëkohore, inovative të efikasitetit dhe energjisë, vlerësojmë që operatorët ekonomikë duhet të zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm dhe të pranueshëm cilësie.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

| KATEGORIA E KERKUAR | PERSHKRIMI I KATEGORISE                                                                                                       | ARGUMENTIMI                                                                        |
|---------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
| 2.a                 | Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike.                                          | Në detyrë projektimi është parashikuar projektim arkitektonik i objekteve.         |
| 2.b                 | 1. objekte sportive të mbuluara ose pjesërisht të mbuluara; 2. qendra tregtare; objekte sociale kulturore; objekte kulturore; | Në detyrë projektimi është parashikuar ndërtim objekti sportiv dhe objekt arsimor. |

|            |                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                                            |
|------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
|            | objekte arsimore;                                                                                                                                                                             |                                                                                                                                                            |
| <b>2.c</b> | Projektim interiere                                                                                                                                                                           | Ne detyre projektimi eshte parashikuar projektim interieri per objektin.                                                                                   |
| <b>2-d</b> | Projektim Peisazhi, Sistemim siperfaqe te gjelberta, lulishte                                                                                                                                 | Ne detyre projektimi eshte parashikuar Ndertim lulishte e siperfaqe te gjelberta, sheshe etj                                                               |
| <b>4.a</b> | Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.                                                                                                                                                 | Ne detyre projektimi eshte parashikuar ndertimi i rrjetit hidro-termosanitar.                                                                              |
| <b>4.b</b> | Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme.                                                         | Ne detyre projektimi eshte parashikuar ndertimi i instalimeve te kondicionimit.                                                                            |
| <b>4.c</b> | Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.                                                                                                                  | Ne detyre projektimi eshte parashikuar ndertimi i rrjetit elektrik.                                                                                        |
| <b>4.f</b> | Projektim të sistemeve kundra zjarrit.                                                                                                                                                        | Ne detyre projektimi eshte parashikuar ndertimi i sistemit te mkz.                                                                                         |
| <b>4.i</b> | Projektimi i ndricimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndricimit te objekteve te medha sportive, porteve aeroporteve, etj.;                                                                      | Bazuar ne termat e referencës, parashikohet realizimi i i ambienteve te jashtme te cilat do te kene ndricim .                                              |
| <b>4.j</b> | Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale. | Ne detyre projektimi eshte parashikuar ndertimi i rrjetit te, citofonisë, internetit, TV, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., |

***Autoriteti Kontraktor per vendosjen e ketyre licensave eshte bazuar ne Detyren e Projektimit, , i cili do te permbaje:***

Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë: - Infrastrukturën e godines - Sistemin kanalizimeve të ujërave të zeza dhe bardha - Rrjetin e ujësjellësit - Sistemin e ndriçimit - Sistemin e ngrohjes dhe ftohjes – Eficencen energjetike - Ambientet sportive dhe rekreative - Rifiniturat dhe cdo pjese tjeter e nevojshme per te permbushur standardet dhe kushtet teknike ne fuqi per nje objekt me kete perdorim - Rritja e sigurise

**2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te ketë si drejtues teknik te pakten stafin si më poshtë dhe te jenë te perfshirë ne listpagesën e shoqërisë për 3 muajt e fundit te deklaruar;**

- 1 (nje) Inxhinier Ndertimi;
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik;
- 1 (nje) Inxhinier Mjedisi;
- 1 (nje) Arkitekt

Operoret ekonomik te kualifikuar te fazes se pare, duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

Për secilin pjestar te stafit kryesor te mesiperm duhet te paraqese, Kontrate pune e vlefshme, diplome,CV.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9, ku të deklarohet disponimi i punonjësit të sipërcituar.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuar më sipër do të paraqitet në rastin kur operatori shpallet fitues ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e ketij kriteri per stafin eshte bere ne perputhje me kerkesat e shprehura ne termat e references

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

- Ing elektrik nevojitet te rishikoje te gjithë informacionin ekzistues lidhur me gjendjen aktuale te ndricimit dhe projekti te jete I realizuar qe te arrije standartin e kerkuar ku parashikohet vendosja e infrastrukturës për rrjetin energjisë elektrike, internetit dhe telefonisë në përputhje me standardin shqiptar.
- Inxhinier ndërtimi  
I cili është i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit si dhe në mbështetje të pikës 1 të nenit 15 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, në të cilin është parashikuar dokumentacioni për pajisje me leje ndërtimi. Po ashtu te pergatise cdo pjese te projektit per cdo nderhyrje qe do mund te behet ne pjeset strukture ne strukturen ekzistuese apo ne shtesa te mundshme
- Arkitekt  
Konsiderohet i nevojshëm pasi në detyrën e projektimit janë përcaktuar detyrat dhe qëllimi për realizimin e projektit të zbatimit ku perfshihet ndarja e ambienteve, ngjyra, dritaret dhe gjitha detyrat e tjera te pozicionit te arkitektit, arredimi
- Ing mjedis I cili është i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit per sistemet mekanike ,

**2.3.2** Një punësim mesatar i të paktën **4 (kater)** personave, për muajin e fundit të vërtetuar me;

**a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve .

**b)** Listpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për për muajin e fundit .

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri per fuqine punetore eshte bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

Eshte kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojmë se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

*Numri prej pesë personave korrespondon me numrin e pesë drejtuesve teknike*

#### **2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë si staf mbështetës si më poshtë:**

1 (një) Inxhinier i pajisur me Certifikate për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplomë dhe certifikatën përkatëse

1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

\*Për Ekspertin Zjarrfikës, ekspertin me vnm dhe menaxherin E Projektit duhet të paraqitet Kontratë Pune, Diplome, Cv, Certifikate si dhe të figurojë në Listpagesat e shoqërisë 3 muajt e fundit.

***Një projektues nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.***

***Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.***

**Shënim:** Sqarojmë se në përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9, ku të deklarohet disponimi i punonjësve të sipërcituar.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Termave të references, natyrës së përgjithshme të shërbimeve që priten të ofrohen. Prezenca e stafit të mesiperm është gjykuar si e domosdoshme dhe e nevojshme për një shpërndarje dhe efikasitet sa më të madh në realizimin e shërbimeve konkretisht;



- **Eksperti zjarrfikes** eshte i domosdoshem te jete prezent gjate hartimit te projekteve te mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vleresimeve perkatese te fushes bazuar ne termat e references
- **Nje punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, gjykohet si i domosdoshem pre realizimin e VNM (Vleresimet e ndikimit ne Mjedis) per projektet qe do te realizohen.

Te dy ekspertete jane te nevojshem pasi pa VNM dhe pa MNZ projektet nuk mund te kalojne oponencen teknike sipas VENDIM Nr. 9, datë 11.1.2024 Për Miratimin E Rregullave Për Projektet Që Duhet T'i Nën Shtrohen Oponencës Teknike Sipas Secilës Fushë Projektimi, Si Dhe Procedurat Që Ndiqen Në Këto Raste

## 2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

**2.4.1.** Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim Eshte vendosur kjo kerkese bazuar ne njoftimin me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik "Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

**2.4.2** Operatori ekonomik ofertues duhet te jete i pajisur dhe te paraqese Certifikatat te pershtatshme **ose ekuivalentet e tyre** per objektin e prokurimit si me poshte:

- ISO 9001:2015 ( Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë e vlefshme ), ose ekuivalent
- ISO 14001-2015 ( Sistemi i Menaxhimit Mjedisor e vlefshme), ose ekuivalent
- ISO 45001-2018 (Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë e vlefshme) ose, ose ekuivalentet

Shënim: Në rastet e Bashkimit te Operatoreve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqese certifikatën e mësipërme në bazë të zërave të marrë përsipër të realizoje sipas marrëveshjes së bashkëpunimit.

**Argumentimi:** Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”

Çertifikatat e cilësisë janë bazuar në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim

Njësia e Prokurimit, në zbatim të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe Urdhrit të Prokurimit Nr.84, datë 03.02.2023, hartoi dokumentet e tenderit për objektin: **“Projektim Rikonstruksion Shkolla Ndoc Mazi”**, me fondin limit : **4,999,556 (Katër milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e gjashtë) pa TVSH,**